



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 8.1 nënparagrafi 8.1.2 të Rregullave (F03) për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë autoriteteve kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave të miratuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik N.T.Sh. "Europa" - Batri Ademi B.I. të datës 16.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të QKMF dhe QMU - Ritender" me nr. të prokurimit 616-22-14303-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 209 211, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar pjesërisht kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik N.T.Sh. "Europa" - Batri Ademi B.I. e datës 16.02.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 15.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të QKMF dhe QMU - Ritender" me nr. të prokurimit 616-22-14303-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 209 211.
- II. **ANULOHE**T njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues - Komuna e Prishtinës i datës 15.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të QKMF dhe QMU - Ritender" me nr. të prokurimit 616-22-14303-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 209 211, si dhe lënda kthehet në rivlerësim.
- III. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që brenda afatit prej pesë (5) ditëve kalendarike duke filluar nga data kur është njoftuar me këtë vendim, të filloj me procedurën e rivlerësimit bazuar në pikën I dhe II të këtij vendimi.
- IV. **NJOFTOHET** menjëherë operatori ekonomik N.T.Sh. "Europa" - Batri Ademi B.I. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim, përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim


Operatori ekonomik N.T.Sh. "Europa" - Bastri Ademi B.I. (tutje si "parashtruesi") me datë 16.02.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 15.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të QKMF dhe QMU - Ritender" me nr. të prokurimit 616-22-14303-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 209 211. Pretendimet e parashtruesit janë lidhur me çmimet abnormalisht të ulta si dhe pretendimin se polica për sigurimin e tenderit nuk është në përputhje me nenin 57 të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik pasi që polica e sigurimit evidenton nr. e prokurimit 616 22 3585-2-1-1 ndërsa numri i saktë i prokurimit për këtë aktivitet të prokurimit është 616 22 14303-2-1-1.


Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 20.02.2023 ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim. Me këtë rast është arritur konstatimi se "Pretendimi i parashtruesit se polica për sigurimin e tenderit nuk është në përputhje me nenin 57 të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik pasi që polica e sigurimit evidenton nr. e prokurimit 616 22 3585-2-1-1 ndërsa numri i saktë i prokurimit për këtë aktivitet të prokurimit është 616 22 14303-2-1-1, është pretendim i saktë dhe i argumentuar në mënyrë të plotë". Ndërsa pretendimit i parashtruesit lidhur me çmimet abnormalisht të ulta nuk është argumentuar mjaftueshëm andaj si i tillë është pretendim vetëm pjesërisht i saktë.

Në përputhje me konstatimet si më sipër, autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës duke u bazuar në parimet e përgjithshme të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik përkatësisht në nenin 7 lidhur me barazinë në trajtim, jo-diskriminimin dhe transparencën, duhet të bëj rivlerësimin e ofertave në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 20.02.2023


Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organiit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.